



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKT LIGJ

Nr. ____/2018

PËR

**RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE KOMISIONIT
EVROPIAN, PËR PROGRAMIN E VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT
NDËRKUFITAR IPA II, SHQIPËRI - KOSOVË 2014-2020, ALOKIMET
PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI